



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13328 / Prot.

Fier më 26 / 12 / 2024

VENDIM

Nr. 142 , Datë 23 / 12 / 2024

“Për skualifikimin nga përfitimi i programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, të familjeve znj.Lindita Fatah Lamaj dhe znj.Klodjana Qani Linfaj (Bajramaj), miratuar si familje përfituese me VKB nr.05, datë 30.01.2024.”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt.23/12/2024, i paraqitet për shqyrtim materiali nga Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier, për skualifikimin nga përfitimi i programit të subvencionit të qirasë në tregun e lire të familjeve znj.Lindita Fetah Lamaj dhe znj.Klodjana Qani Linfaj (Bajramaj), miratuar si familje përfituese me VKB nr.05, datë.30.01.2024“Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë”.

Bazuar në procedurat administrative të Bashkisë Fier të iniciuar nga kërkesa zyrtare e familjes përfituese znj. Lindita Fetah Lamaj për heqje dorë nga ky program, si dhe për familjen përfituese znj.Klodjana Qani Linfaj (Bajramaj) e cila nuk ka përmbushur kërkesat ligjore që burojnë nga dokumentacioni ligjor mbi bazën e të cilit është miratuar si familje përfituese për depozitimin e kontratës së qirasë së rifreskuar/rinovuar, Komisioni i Strehimit, Bashkia Fier, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës për të dyja rastet, bazuar në Ligjin Nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim si pas çdo program social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”,VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Kërkesës nr. 13151 Prot,datë.13.12.2024 “Për heqjen dorë nga bonusi i qirasë, si dhe shkresa nr.10401Prot, datë 11.10.2024 “Njoftim për vënie në dispozicion të dokumentacionit të rifreskuar”, neni 24 dhe neni 54, gërma “k” të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar. Këshilli i Bashkisë për sa më sipër,

VENDOSI:

1.Të skualifikojë nga përfitimi i programit të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, për periudhën e mbetur të vitit 2024,familjet e miratuara si përfituese, si më poshtë:

-Lindita Fetah Lamaj
-Klodjanaan Qani Linfaj (Bajramaj)

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financë Buxhetit, Bashkia Fier.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT
ANTONETA ÇUNAJ**

